



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

I	Data	02.11/18	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01 Nr. 60/01-34743/2018				

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së X (Dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 30 Tetor 2018.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e X (Dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 30 Tetor 2018 dhe atë:

1. Rregulloren për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajejen e tyre/ Lënda: 01Nr. 07-104/01-34317/18;
2. Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të komunës për vitin 2018/ Lënda: 01Nr. 400/01-34711/18;
3. Vendimi për formimin e Komitetit Konsultativ të Personave me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut / Lënda : 01Nr. 104/02-34370/18;
4. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, Agjencisë të punësimit të Republikës së Kosovës / Lënda : 01Nr. 104/02-31498/18;

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 07-104/01-34317/18
Kaçanik, 30.10.2018

RREGULLORE Nr. 03/2018

PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE

Tetor, 2018

Në mbështetje të dispozitave 12.2 (c) lidhur me nenin 40.2(a) dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të neneve 6(q) dhe neni 83 (e) lidhur me nenin 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 3588/2008 dt. 25. 09. 2008, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur me 30 Tetor 2018, Aprovoj këtë:

RREGULLORE Nr. 03/2018 PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
2. Rregullimi i varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale e interesit publik.

Neni 2 Përkufizimet

1. Me këtë rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - 1.1. “Vend-varrezë” nënkuptojmë varrin dhe varrezat familjare;
 - 1.2. “Varr” nënkuptojmë gropën e gërmuar në tokë për të futur të vdekurin (kufomën) ose mbetjet mortore;
 - 1.3. “Varrezë” nënkuptojmë vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur të vdekurin dhe hapësira tjetër përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë (hapësira qarkulluese, e parkimit dhe e shërbimeve tjera);
 - 1.4. “Varrmihës” nënkuptojmë punëtorin që hap varre në varreza;
 - 1.5. “Varrim” nënkuptojmë ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr;
 - 1.6. “Varrhumbur” nënkuptojmë humbjen e varrit, që nuk dihet se ku është varrosur;
 - 1.7. “Kufomë” është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore ;
 - 1.8. “Shërbim i varrimit” është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës;
 - 1.9. “Zhvarrim” është nxjerrja e kufomës ose mbetjeve mortore nga varri;
 - 1.10. “Zhvarrim i zakonshëm” është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes;
 - 1.11. “MAPL” është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;

- 1.12. “DSHPE” është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;
- 1.13. “KBF” Këshillat e Bashkësive Fetare;
- 1.14. “Ekshumimi” - zhvarrosje, nxjerrja e kufomës nga varri;
- 1.15. “Zhvarrim i jashtëzakonshëm” është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik;
- 1.16. “Kohë e prehjes” është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.

Neni 3 Varrezat

1. Në aspektin e hapësirës dallojmë këto varreza:
 - 1.1.varreza të vogla (deri në 5 ha);
 - 1.2.varreza të mesme (prej 5 deri në 20 ha) dhe
 - 1.3.varreza të mëdha (mbi 20 ha).
2. Hapësira e përcaktuar për varreza duhet të jetë e paraparë me planin zhvillimor të komunës ose me plan të veçantë në pajtim me planin zhvillimor të komunës;
3. Varrezat duhet t’i përmbushin nevojat për varrosjen e të vdekurve në një vendbanim (fshat), disa vendbanime dhe brenda lagjeve lokale në qytet.

Neni 4

1. Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese përcaktohet me plan dhe programin për marrjen e masave për rregullimin e gjendjes në hapësirë;
2. Planin dhe programin përfshinë periudhën se paku 100 vjet për varreza të reja, kurse për zgjerimin e varrezave ekzistuese më së paku 30 vjet me mundësi të zgjerimit në etapa;
3. Varrezat ekzistuese mund të zgjerohen, nëse për to ekziston hapësira e paraparë me planin zhvillimor të komunës dhe nëse janë të siguruara edhe kushtet tjera të parapara me këtë rregullore dhe me ligjet në fuqi.

Neni 5

1. Sipas mënyrës së themelimit, respektivisht mënyrës së vdekjes, varrezat klasifikohen në të përgjithshme (publike) dhe të veçanta;
2. Në varreza të veçanta hyjnë: varret me përmendore, varret ushtarake, varret e heronjve dhe dëshmorëve, varret anonime, varret masovike prej fatkeqësive natyrore dhe varret sipas përkatësisë fetare.

Neni 6

1. Sipërfaqja e nevojshme neto për varr duhet të jetë 2. 20 metra katror për banor;
2. Te përcaktimi i sipërfaqes për varr, duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrit;

3. Sipërfaqja neto e varrit, përfshinë parcelën/vendin e varrit;
4. Sipërfaqja bruto e varrit, përfshinë neto sipërfaqen e varrit të rritur edhe për distancën në mes varreve.

Neni 7

1. Varrezat duhet vendosur në një vend me sipërfaqe të mjaftueshme, i përshtatshëm sipas konfiguracionit dhe kushteve të lokacionit për varrosje;
2. Vendi i varrezave duhet të jenë jashtë vendbanimit ose afër vendbanimit me qasje në rrugë dhe me shtegun (rrugicë e ngushtë) e ndarë për këmbësorë;
3. Hapësira për varreza duhet t'i përmbush këto kriterë:
 - 3.1 Sipas pozitës së varrezave, toka duhet të jetë e kulluar, me rreze dhe e qetë të jenë larg rrjedhave nëntokësore dhe sipërfaqësore të ujërave, jashtë zonave të ujërave të mbrojtura, zonave të cilat vërshohen nga ujërat, zonave të mbrojtura natyrore dhe rajoneve malore.
 - 3.2 Varrezat e reja duhet të jenë së paku 30 m nga qendra të ndërtuara ose që do të ndërtohen, ndërtesa të dedikuara për çështje afariste.
 - 3.3 Tek zgjerimi i varrezave ekzistuese, largësia duke pasur parasysh pikën 3 të nenit 7, mund të jetë deri në 10 m me kusht që për gjatë varrezave të sigurohet një shirit gjelbërues në gjerësi minimale prej 5 m i cili e përshkon tërë gjatësinë e objekteve kontaktuese.

Neni 8

1. Varrezat përbëhen prej:
 - 1.1 Vendi të varrit (vetë varri) ;
 - 1.2 Radhët e varrezave të cilën e përbëjnë një mori varresh (varret);
 - 1.3 Fushat e varrezave (disa rende të varreve por jo më tepër se 200 varre në një shteg);
 - 1.4 Shtegu i cili lidh grupet e varreve me fushën e varreve ose rendin e varreve;
 - 1.5 Shtigjet kryesore të cilat lidhin fushat e varreve, me pushimore dhe hapësirën për zgjerim;
 - 1.6 Rrugëve interne dhe eksterne (jashtme) për qarkullimin e automjeteve dhe parkimin ;
 - 1.7 Gjelbërimet (grupore dhe përcjellëse) ;
 - 1.8 Vendi ku bëhet përshëndetja e fundit lamtumirës, mund të jetë i mbyllur ose i hapur në përputhje me rregullat sipas përkatësisë fetare ;
 - 1.9 Objektet tjera përcjellëse shërbyese për kufomën (hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare) ;
 - 1.10 Parkingu për automjete.

Neni 9

1. Varri është gropa e varrit me proporcion sipas normave urbanistike:
 - 1.1. 1.00 x 0.60 m - deri në moshën 3 vjet ;
 - 1.2. 1.50 x 0.60 m – 1.50 x 0.75 m prej moshës 4 vjet deri në moshën 10 vjet ;
 - 1.3. 2.10 x 0.70 m – 2.50 x 1.20 m mbi 11 vjet ;

2. Fundi i gropës së varrit sipas grupeve të përcaktuara në paragrafin 9.1 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë më së paku 50 cm mbi nivelin e pikës më të lartë të ujërave nëntokësore;
3. Thellësia e varrit përcaktohet në bazë të rregullave sipas rriteve fetare e që nuk mund të jetë më e thellë se 180 cm ;
4. Dimensionet e varrezave familjare janë 2.40 x 2.80 m, maksimalisht 4 varreza ;
5. Mbulesa e varrit mbi kufomë, duhet të bëhet sipas rriteve fetare;
6. Lartësia e varrezave familjare dhe e përmendoreve mund të jetë më shumti deri në 2 m. Në to mund të shënohen atributet e personit të vdekur (emri, mbiemri, viti i lindjes dhe i vdekjes).

Neni 10

1. Varri mund të bëhet edhe me mur prej betoni ose prej materiali tjetër;
2. Varrezat duhet të jenë të renditura në atë mënyrë që rendet e varrezave të mos të jenë më të gjata se 60 m;
3. Fushat e varrezave përbëhen prej rendeve të varrezave dhe distancës ndërmjet tyre që shërben si shteg për të shkuar deri te varri;
4. Fushat e varrezave duhet të jenë të ndara me shtigje kryesore me gjatësi minimale prej 3 m;
5. Shtigjet duhet të jenë të ndërtuara prej materialit të fortë pa pengesa për lëvizje dhe jo më të pjerrtë se 8% ndërsa tërthorazi jo më pjerrtë se 1%.

Neni 11

Me rastin e varrosjes, duhet të mbahet evidenca nga ana e organit kompetent - këshillat e bashkësive fetare (KBF) - respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrjes tjetër e specializuar për këtë çështje të autorizuar.

Neni 12

1. Në pajtim me nenin 8 pika (9) të kësaj rregulloreje, objektet tjera përcjellëse shërbyese, hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare, mund të jetë: me thupra metalike me bazament ose material tjetër bashkëkohor, ndërtohen në bazë të një plani të veçantë në pajtim me planin e përgjithshëm të varrezave;
2. Hapësira për qëndrimin e kufomës duhet të jetë e ndërtuar duke pasur parasysh rregullat e rriteve fetare të komuniteteve;
3. Parku i automjeteve, duhet të jetë jashtë varrezave dhe i ndarë nga rruga publike;
4. Rrugët e këmbësorëve – shtigjet rregullohen si trotuare të pavarura për qasje deri te vend varrimi dhe të përshtatshme për kalim për personat me karrocë (hendikep).

Neni 13

Mirëmbajtja e varrezave

1. Organi kompetent – këshillat e bashkësive fetare, ndërmarrja publike ose ndërmarrjes tjetër e specializuar për këtë çështje, administron me punët e varrimit, të rregullimit dhe mirëmbajtjes së varrezave në qytet dhe fshatra, nëse ndryshe nuk është e rregulluar me ligj;

2. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me pietet dhe dinjitet, duke respektuar të gjitha konfesionet fetare;
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, anëtarët e të gjitha feve do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale sipas kushteve të parapara me këtë rregullore.

Neni 14

14.1 Punët e varrimit, të rregullimit dhe të mirëmbajtjes së varrezave në territorin e Komunës i kryen KBF, banorët e atij vendbanimi, apo ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar dhe e kontraktuar për këtë qëllim.

14.2 Punët e varrimit të veteranëve të UÇK-së, në kompleksin e varrezave të dëshmorëve të UÇK-së në Komunën së Kaçanikut, i kryejnë organet komunale në bashkëpunim me Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK- dega në Kaçanik, respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar dhe e kontraktuar për këtë qëllim.

14.3 DSHPE – ja, gjegjësisht ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar dhe e kontraktuar për këtë qëllim, është përgjegjëse për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe varrezave të veteranëve të UÇK-së në territorin e Komunës së Kaçanikut, mirëmbajtjen e lapidarëve, pllakave përkujtimore të cilat gjenden nëpër hapësira publike.

Neni 15

1. Punët në vështrim të nenit 14 të kësaj rregulloreje rregullohen me kontratë administrative në pajtim me rregullat për prokurimin publik dhe shërbimeve publike;
2. Me leje të KBF dhe DSHPE-së, rregullimin e varrit mund ta bëjë edhe anëtari i familjes së të vdekurit.

Neni 16

1. Mirëmbajtja e varrezave, në vështrim të kësaj rregulloreje përfshinë: objektet tjera përcjellëse shërbyese (hapësira për qëndrim të kufomës), ndriçimin publik, rrugët kalimtare, shtigjet, kroit për ujë, rrethojën e varrezave, parkun e automjeteve, stabilimentet sanitare, gjelbërimin, pastërtinë dhe rendin në varreza;
2. Mirëmbajtja (disa punë zëjtare) në varr dhe varreza familjare mund të bëhen nga ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë çështje, përjashtimisht edhe nga vet familjarët e të vdekurit në këto kushte:
 - 2.1. Të merret leja nga ana organit kompetent KBF, (DSHPE) ose ndërmarrja publike e autorizuar;
 - 2.2. Koha e kryerjes së punëve duhet të jetë prej orës 07:00 – 18:00 në ditët e punës;
 - 2.3. Materiali ndërtimor (rëra, zhavorri, hekuri dhe materiali tjetër) lejohet të qëndroj në varreza për kohë të shkurtër në mënyrë që të mos pengoj lëvizjen e vizitorëve në varreza dhe pas kryerjes së punëve duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme;

- 2.4. Transporti i materialit, duhet të bëhet vetëm nëpër rrugë dhe shtigje që i cakton dhënësi i lejes;
- 2.5. Gjatë punimeve nëse haset në ndonjë pjesë të arkivolit ose ndonjë asht (kockë) duhet të mbulohen në të njëjtin vend;
- 2.6. Nëse gjatë punimeve gjinden sende me vlerë duhen t' i dorëzohen Organeve kompetente – KBF -së, Policisë së Kosovës;
- 2.7. Kroi, gjatë përdorimit duhet të përdoret me kujdes që mos t'ju shkaktohet dëmi varreve dhe varrezave tjera;
- 2.8. Për vendosjen e pllakave përkujtimore ose përmendoreve, duhet të paraqitet kërkesë e veçantë në KBF, me skicën e objektit, respektivisht përmendores.
- 2.9. Shpenzimet lidhur me kryerjen e punëve sipas paragrafit 2 të këtij neni bien në barrë të atij i cili bënë kërkesën për rregullimin e varrit dhe varrezave familjare.

Neni 17

1. Planin e mirëmbajtjes së varrezave, kushtet dhe tarifat i cakton DSHPE-ja në bashkëpunim me KBF-në.
2. Për tarifa nxirret vendim i veçantë nga ana e Kuvendit të Komunës – apo me rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba me propozim të DSHPE-së.

Neni 18

Sjellja në varreza

1. Vizituesit e varrezave janë të detyruar që në varreza të sillen në mënyrën e cila i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurve dhe me dinjitet në vendet ku ato prehen;
2. Në varreza nuk mund të sillen fëmijët deri në moshën 10 vjeçare. Përfshimisht me përcjelljen e prindërve, personave tjerë të moshuar ose kujdestarit të tij.

Neni 19

1. Në varreza ndalohet:

- 1.1. Shkatërrimi me qëllim i vendvarrimeve;
- 1.2. Shkelja dhe kapërcimi nëpër varre dhe varreza dhe shlyerja e tyre;
- 1.3. Shkaktimi i dëmit në varreza ose në shenjat tjera përkujtimore (në përmendore dhe objekte tjera përkujtimore në varreza);
- 1.4. Prishja e rendit në varreza;
- 1.5. Thyerja e rrethojave në varreza, dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, drunjtë dhe bimëve tjera të mbjella në varreza;
- 1.6. Hyrja në hapësirën e varrezave me automjete dhe mjete tjera tërheqëse pa pëlqim paraprak;
- 1.7. Lëshimi i bagëtive në varreza;
- 1.8. Krijimi i papastërtisë në shtigjet dhe në sipërfaqet e gjelbëruara, vërja ose hedhja e kurorave të vyshkura, luleve të vyshkura ose sendeve tjera;
- 1.9. Fotografimi pa leje i varrezave për çështje profesionale;

- 1.10. Sjellja dhe lërja pa leje e sendeve të ndryshme në varre dhe varreza që nuk kanë të bëjnë me varre dhe varreza;
- 1.11. Hyrja në objektin ku qëndron kufoma dhe objektet tjera jashtë kohës së përcaktuar për varrim;
- 1.12. Ndezja e qirinjve jashtë shtëpizave të parapara në varreza;
- 1.13. Qëndrimi i lypsarëve brenda dhe në hyrje të varrezave;
- 1.14. Hedhja e mbeturinave brenda në varreza dhe jashtë varrezave.
- 1.15. Djegia e hapësirave brenda varrezave.
- 1.16. Pjesëmarrja në zhvarrimin e kufomave që nuk i përkasin familjes, përveç rasteve kur ka pëlqimin e palëve, që kanë të drejtë sipas autorizimit të veçantë.

Neni 20

Varrimi dhe veprimet tjera lidhur me varrimin

1. Varrimi bëhet në pajtim me dispozitat sanitare edhe sipas mënyrës që i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurit, në sajë të nderimit të ndjenjave të farefisit dhe të personave tjerë të cilët kanë qenë në afërsi me të vdekurin;
2. Varrimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë vërtetuar vdekja në mënyrë të caktuar me dispozita të veçanta;
3. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet edhe në varrezat të cilat i ka caktuar i vdekuri për së gjalli, ose në varrezat që i zgjedhë familja e tij ose personat të cilët kujdesen për varrosjen e tij.

Neni 21

1. Lejen për varrimin e të vdekurit në varrezat e caktuara dhe për vendvarrim në qytet dhe fshat e jep KBF-ja, DSHPE-ja, respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar e autorizuar si dhe në koordinim me zyrën e gjendjes civile në komunë;
2. Lejen për zhvarrimin dhe bartjen e eshtrave të kufomës në vendvarrim të ri e bënë Inspektori Sanitar, bazuar në dispozitat ligjore me kusht që zhvarrimi dhe bartja e eshtrave të behët në pajtim me dispozitave ligjore dhe prezencë të Inspektorit Sanitar.
3. Paraqitësi i kërkesës është i detyruar të bëjë dezinfektimin e rrethit të gropuar, sëndukut dhe automjetit nga ana e punëtorëve të autorizuar.
4. Punëtorët që punojnë në zhvarrim duhet të kenë rroba mbrojtëse për punë siç janë: çizme gome, dorëza, maska, mantel bezi dhe polivinili si dhe punëtorët nuk guxojnë të kenë lëndime dhe dëmtime në duar. Pas punës së kryer uniformat e punës dhe mjete e punës të dezinfektohen.
5. Kufoma duhet të jetë në sënduk druri e sënduku druri në atë metalik dhe me fletë-përcjellje.

Neni 22

1. Bartja e kufomave bëhet me arkë për kufoma (arkivol);
2. Deri në aktin e varrosjes, kufomat duhet të ruhen në lokale të caktuara për këtë qëllim;
3. Bartja e kufomave deri te varrezat bëhet sipas rregullave të riteve fetare të komuniteteve.

Neni 23

Bartjen e kufomave në territorin e komunës e bënë KBF-ja, ndërmarrja publike e specializuar komunale ose ndërmarrja tjetër e specializuar e kontraktuar për këtë qëllim apo nga ana e vetë familjarëve.

Neni 24

Para varrimit, kufomat e personave të merituar, heronjve dhe dëshmorëve dhe personave tjerë me merita të veçanta, mund të ekspozohen në vendin e caktuar jashtë varrezave me qëllim të dhënies së nderimit të veçantë të pasvdekjes, nëse organizimi i vdekjes bëhet nga organet komunale, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së ose organet qendrore të shtetit.

Neni 25

1. Nëse veprimtaria e varrimit organizohet nga ndërmarrja publike lokale ose ndërmarrja tjetër publike e specializuar, është e detyruar që për varrimin e të vdekurve të siguroj shërbimin e përditshëm, duke përfshirë edhe të dielat dhe festat shtetërore siç vijon:

- 1.1. Prej 1 majit deri me 30 shtator prej orës 8:00 deri në orën 18:00 më së voni deri në ora 20:00;
- 1.2. Prej 1 tetorit deri më 30 prill prej orës 8:00 deri në ora 16:00, më së voni deri në ora 18:00.

2. Veprimtaria e varrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, rregullohet me anë të kontratës në mes të KBF DSHPE-së dhe ndërmarrjes publike lokale të specializuar ose ndërmarrjes tjetër të specializuar për këtë qëllim.

Neni 26

Dhënia e nderimit të fundit (të pasvdekjes) mund të bëhet në hapësirën e përcaktuar në vend-varreza.

Neni 27

1. Me lejen e organit kompetent komunal (DSHPE) dhe inspektoratit sanitar, mund të bëhet zhvarrosja (nxjerrja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur – rivarrosur në një vend-varrezë tjetër ose për çështje tjera (ekshumacionin e kufomave);
2. Lidhur me pikën 1 të këtij neni mbahet procesverbali nga ana e organit kompetent (DSHPE) ose personit tjetër të autorizuar (inspektorit sanitar) për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët;
3. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvendosjes dhe çështjeve tjera (ekshumacionin e kufomave) bien në barrë të vetë atij i cili ka kërkuar zhvendosjen e mbetjeve të kufomës ose për çështje tjera (ekshumacionin).

Neni 28

Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë organi kompetent për çështje të shërbimeve komunale (DSHP-ja) si dhe inspektorit sanitar (përkatës);
2. Inspektorati sanitar gjatë mbikëqyrjes mund të merr masa dhe të urdhëroj marrjen ose mos marrjen e një veprimi të caktuar në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e aplikueshme të ligjit;
3. Në vendimin e inspektoratit mund të ushtrohet ankesa në afatin prej 30 ditësh nga dita e njoftimit, drejtuar Kryetarit të Komunës.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 29

1. Për shkelje të nenit 16 paragrafi 2, nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafët 1 – 16 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 1.1. Personi fizik në shumën prej 10€ - 100€;
 - 1.2. Personi i biznesit individual prej 10€ - 100€;
 - 1.3. Personi përgjegjës i personit juridik prej 30€ - 250€
 - 1.4. Personi juridik prej 100€ - 1500€.
2. Për shkelje të nenit 10 paragrafi 2,3,4 dhe 5 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 2.1. Personi fizik që ushtron biznes individual prej 30€ - 250€,
 - 2.2. Personi përgjegjës i personit juridik, 30 € - 250€ dhe
 - 2.3. Personi juridik dënohet 100€ - 1500€.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 30.


Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë dispozitat ligjore.

Neni 31

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës dhe në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi , Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević , Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL Data: 06.11.2018 Nr.352-1272
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Rregullore

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktet komunal në vijim:

Rregullorja 01Nr.104/01-34317/18, për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
I miratuar më datë: 30.10.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.11.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është **në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekt juridik.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 400/01-34711/18
Kaçanik, 30.10.2018

Në mbështetje të nenit 24 lidhur me nenin 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare Nr.27 / 03 Qershor 2008) të nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27 / 03 Qershor 2008) si dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës të datës 25.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 30 Tetor 2018, mori këtë:

VENDIM

PËR RREGULLIMIN E NDARJEVE BUXHETORE TË KOMUNËS PËR VITIN 2018

1. Buxheti i Komunës do të rialokohet brenda programeve/nën programeve buxhetore për projekte kapitale deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal.
2. Rialokimet brenda pikës së 1. të këtij vendimi do të reflektojnë në këto nën programe dhe për këto projekte:
 - 2.1 Shërbimet Publike-Infrastruktura rrugore: Projektet: “Rregullimi i trotuarit ne lagjen Imisht” me kod 46548 në shumë, 495.00 €, projekti “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe vendosja e shportave” me kod 43995 në shumë prej 350.00 €, projekti “Ndërtimi i trotuarit ne fshatin Bajnicë” me kod 46572 në shumë, 690.00 euro dhe projekti “Asfaltimi i rrugës Terziu ne fshatin Doganaj” me kod 46677 ne shumë, 665.00 €.
 - 2.1.1 →Mjetet e kursyera nga këto projekte që arrijnë shumën totale, 2,200.00 €, do të shfrytëzohen për projektin “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësve” me kod 45490 të i njëjti nën-program buxhetor.
3. Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik: Projekti “Rregullimi i rrugëve ne lagjen Dushkajë” me kod 46696.
 - 3.1 →Mjetet e kursyera nga këto projekte që arrijnë shumën totale, 3,087.00 euro, do të shfrytëzohen për projektin “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale” me kod 45345 të i njëjti nën program buxhetor.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi mbi Rregullimin e Ndarjeve Buxhetore për Vitin 2018, obligohet Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Financave.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës, ndërsaq do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim njoftohen; Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit – përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante; dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01- Nr. 400/01-3771/18
Kaçanik; 19.10.2018

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në mbështetje të nenit 24 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji nr 03/L 048) neni 30, paragrafi 30.1 ,Kryetari i Komunës i Propozon Kuvendit Komunal këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR RREGULLIMIN E NDARJEVE BUXHETORE TË KOMUNËS PËR VITIN 2018

I

Buxheti i Komunës do të rialokohet brenda programeve/nën programeve buxhetore për projekte kapitale deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal.

II

Rialokimet brenda pikës së **I-rë** të këtij vendimi do të reflektojnë në këto nën programe dhe për këto projekte:

1.Shërbimet Publike-Infrastruktura rrugore: Projekteti “Rregullimi i trotuarit ne lagjen Imisht” me kod 46548 në shumë prej 495.00 euro, projekti “Krijimi I hapsirave xhelbruese dhe vendosja e shportave” me kod 43995 në shumë prej 350.00 euro, projekti “Ndertimi I trotuarit ne fshatin Bajnicë” me kod 46572 në shumë prej 690.00 euro dhe projekti “Asfaltimi I rruges Terziu ne fshatin Doganaj” me kod 46677 ne shumë prej 665.00 euro.

→Mjetet e kursyera nga këto projekte që arrijnë shumën totale prej 2,200.00 euro, do të shfrytëzohen për projektin “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellsëve” me kod 45490 te i njeiti nënprogram buxhetor.

III

2.Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik: Projekti “Rregullimi i rrugeve ne lagjen Dushkajë” me kod 46696

→Mjetet e kursyera nga këto projekte që arrijnë shumën totale prej 3,087.00 euro, do të shfrytëzohen për projektin “Rregullimi dhe asfaltimi I rrugeve lokale” me kod 45345 te i njeiti nënprogram buxhetor.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi mbi Rregullimin e Ndarjeve Buxhetore për Vitin 2018, obligohet Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Financave.

V

Ky vendim i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim, ndërsa do të hynë në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.



Besim Hazi, Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-34370/18
Kaçanik, 30.10.2018

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 20108) të nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të nenit 31, 32 lidhur me nenin 39.3 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryesuesit të Kuvendit 01Nr. 104/02-34370/18 prej datës 19.10.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me datë: 30 Tetor 2018, mori këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMITIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Kryesuesit të Kuvendit 01Nr. 104/02-34370/18 i datës 19 Tetor 2018 -Për Themelimin e Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Kaçanikut.
2. Komiteti Konsultativ nga pika 1. e këtij Vendimi do të përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, nga qytetarë dhe përfaqësues të Organizatave Joqeveritare të cilët janë njohës të fushave përkatëse.
3. Caktimi i anëtarëve të Komitetit të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet përmes shpalljes së Konkursit Publik, për mandat 4 vjeçare, me mundësi të përzgjedhjes edhe për një mandat, përcaktuar si në Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016.
4. Kuvendi i Komunës shpallë Konkursin dhe përcakton kriteret për konkurrim.
5. Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ, formon Panelin, në përbërje:

1. Ahmet Luma,	anëtar nga Kuvendi;
2. Kaltria Tafili,	anëtare nga Kuvendi;
3. Arlinda Rakoci- Raka ,	anëtare nga Kuvendi;
4. Festim Neziraj,	anëtar nga Ekzekutivi; dhe
5. Elmihane Krasniqi,	anëtare nga Shoqëria Civile.

6. Paneli për zgjedhës nga pika 5 e këtij Vendimi, punon sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016- Për Procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative dhe ia propozon Kuvendit të Komunës Listën e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut, për miratim
7. Kompetencat e Komiteteve Konsultative janë: Dhënia e propozim rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të Kryetarit të Komunës, Komiteteve të Përhershme apo Kuvendit të Komunës në fushën përkatëse, paraqitjen e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuara, propozime këto të cilat nuk janë obliguese për Kuvendin e Komunës, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.
8. Çështjet të tjera lidhur me Komitetin Konsultativ do të rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2016 - Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.
9. Për punën që kryejnë anëtarët e komitetit konsultativ, do të kompensohen në proporcion me mëditjet e anëtarëve të Komiteteve të përhershme(nga 50 € për një mbledhje), por jo më shumë se 6 mbledhje brenda një viti.
10. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.
11. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarët e Panelit Përzgjedhës dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-34370/18
Kaçanik, 19.10. 2018

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 20108) të nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të nenit 31, 32 lidhur me nenin 39.3 të Statutit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës me Kërkesën e Handikos njësia në Kaçanik 01Nr. 104/02-34370/18, i drejtohet Kuvendit të Komunës me këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMITIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim bëhet themelimi i Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Kaçanikut.
2. Komiteti Konsultativ nga pika 1. e këtij Vendimi përbëhet pesë(5) deri në shtatë (7) anëtarë, qytetarë dhe përfaqësues të Organizatave Joqeveritare të cilët janë njohës të fushave përkatëse.
3. Caktimi i anëtarëve të Komitetit të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet përmes shpalljes së Konkursit Publik, për mandat 4 vjeçare, me mundësi të përzgjedhjes edhe për një mandat.
4. Kuvendi i Komunës shpallë Konkursin dhe përcakton kriteret për konkurrim.
5. Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ, formon Paneli, në përbërje:
 1. _____ përfaqësues i Kuvendi,
 2. _____ përfaqësues i Kuvendit,
 3. _____ përfaqësues i Kuvendit,
 4. _____ përfaqësues i Ekzekutivit dhe
 5. _____ përfaqësues nga Shoqëria Civile.
6. Paneli përzgjedhës nga pika 5 e këtij vendimi, ia propozon Kuvendit të Komunës Listën e anëtarëve për Komitetin Konsultativ për miratim.

7. Kompetencat e Komiteteve Konsultative janë: Dhënia e propozim rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të Kryetarit të Komunës, Komiteteve të Përhershme apo Kuvendit të Komunës në fushën përkatëse, paraqitjen e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuara, propozime këto të cilat nuk janë obliguese për Kuvendin e Komunës, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.
8. Çështjet të tjera lidhur me Komitetin Konsultativ do të rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2016- Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.
9. Për punën që kryejnë anëtarët e komitetit konsultativ, do të kompensohen në proporcion me mëditjet e anëtarëve të Komiteteve të përhershme(nga 50 € për një mbledhje), por jo më shumë se 6 mbledhje brenda një viti.
10. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.
11. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, anëtarët e Panelit Përzgjedhës dhe Arkivi.





Data	18.10.2018	Vendi	Kaçanik
J. org.	Numri	Shtojcë	
01-104/02-39370/18			

Data	18.10.2018
Për	Kemajl Murseli/Kryesuesin e Kuvendit Komunal-Kaçanik
Nga	Elmihane Krasniqi/Handikos-Kaçanik
Përmes	
Lënda	Kërkesë Për Themelimin e Komitetit Konsultativ Për Personat me Aftësi të Kufizuara

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 neni 73 si dhe statutit të komunës së Kaçanikut neni 31,32, 33 parashihet themelimi i komiteteve konsultative, prandaj në bazë të Udhëzimit Administrativ(MAPL) Nr.01/2016 Për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna përkatësisht nenit 5 pika 1.3 ne si Handikos në Kaçanik propozojm:

Themelimin e Komitetit Konsultativ Për Personat me Aftësi të Kufizuar në komunën e Kaçanikut.

Arsyeshmëria

Ekzistojn tre dokumente referente në të cilat mund të arsyetohet themelimi i këtyre komiteteve si Ligji Për Vetëqeverisje Lokale pastaj Statuti i komunës së Kaçanikut si dhe Udhëzimi Administrativ(MAPL) Nr.01/2016 Për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna. Por, përpos arsyetimit normativ juridik ne mendojm që edhe konteksti i integrimit social të personave me aftësi të kufizuara është arsyeje e mjaftueshme për themelimin e këtij komiteti, ngase ekzistenca e këtyre komiteteve do të reflektonte edhe plotësimin e obligimeve ligjore por edhe vullnetin e institucioneve tona për përfshirjen në formën e konsultimeve, propozimeve e kritikave qytetarin, duke e trajtuar edhe atë si pjesë e vendimarrjes institucionale.

Si Handikos në Kaçanik kemi të evidentuar tanimë 400 Persona me Aftësi të Kufizuara. Personat e kesaj kategorie tanimë janë një komunitet i caktuar si pjesë e shoqërisë sonë. Ne po përpiqemi që të i inkurajojm dhe integrojm ata në jetën sociale e publike në përgjithësi. Prandaj, edhe Themelimi i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara do të ishte pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të interesave të tyre në institucionet komunale .



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL Datë: 06.11.2018 Nr.020- 1271
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktet komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.104/02-34370/18 për themelimin e komitetit konsultativ për personat më aftësi të kufizuar në komunën e Kaçanikut.
I miratuar më datë: 30.10.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.11.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekt juridik.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-34197/2018

Kaçanik, 30.10.2018

Në bazë të nenit 12 lidhur me nenin 14 të Ligjit Nr.03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 7.3 lidhur me nenin 10 të Ligjit Nr.04/L-144 - Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronë së paluajtshme të Komunës(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 35/17 Dhjetor 2012), të dispozitave të nenit 20 të Rregullores QRK 23/2013 -Për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 Tetor 2018, merr këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, AGJENCISË SË PUNËSIMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Me këtë Vendim, i Epët në shfrytëzim afatgjatë – Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, prona e paluajtshme komunale në Parcelën Kadastrale **Nr.00587-2**, në sipërfaqe të përgjithshme, **300m²**, Zona Kadastrale Kaçanik, e evidentuar në emër të P.SH. Komuna Kaçanikut, për Ndërtimin e Zyrës së Punësimit në Kaçanik.
2. E drejta e dhënies në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, i epët për afat të gjatë kohor për: **99 Vite, pa kompensim**, në përputhje me kriteret e përcaktuara për raste të veçanta, sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar si në pikët 1. dhe 2. të këtij Vendimi, rregullohet me Kontratë të veçantë të cilën do ta nënshkruajnë, Kryetari i Komunës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)- Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pronën e paluajtshme të e regjistroj në RDPP.
5. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Certifikata me Numër të Lëndës: 06-0402-34197-2018 e lëshuar me datë: 22.10.2018.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Kaçanikut.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e regjistrimit të protokollit të MAPL si dhe 7 Ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetarin të Komunës, Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, -përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Assembly

01-Nr. 104-/02-341972018

Kaçanik, 22.10.2018

Në bazë të nenit 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 7 dhe 10 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Ligji Nr.04/L-144, nenit 14.1 të Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.2012/02 për zbatimin e Ligjit për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës, merr këtë

PROPOZIM VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJAT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS AGJENSIONIT TË PUNËSIMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I.

Me këtë Propozim Vendim **IPET** në shfrytëzim afatgjatë - Agjensionit të Punësimit të Republikës së Kosovës prona komunale për ndërtimin e Zyrës së Punësimit në Kaçanik dhe atë: parcela kadastrale **nr. 00587-2**, në sipërfaqe të përgjithshme prej **300 m2**, Zona Kadastrale **Kaçanik** evidentuar në emër të P.SH. Komuna e Kaçanikut..

II.

E drejta e dhënies në shfrytëzim afat gjatë e pronës së paluajtshme Komunale jepet në afat prej **99 vite pa kompenzim** në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

III.

Për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të pronës së paluajtshme Komunale do të vendosë Kuvendi i Komunës Kaçanik.

IV.

Obligohet Drejtoria për urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pronën e paluajtshme ta regjistroj në RDPP.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesohet: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Kaçanik

VI..

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale dhe publikimit në ueb- faqen e Komunës..

Arsyetim

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit duke u bazuar në Palnin Zhvillimor Komunal si dhe kërkesës së MPMS-Agjensioni i Punësimit i Republikës së Kosovës për dhënien në shfrytëzim afat gjatë për 99 vite pa kompenzim, të pronës së paluajtshme komunale e cila ka të bëjë me ndërtimin e Zyrës së Punësimit në Kaçanik e që është me interes publik për Institucionet Shtetërore, në mënyrë që qytetarët e Republikës së Kosovës të mund ti kryejnë Shërbimet dhe ti realizojnë të drejtat e tyre, andaj ky organ duke iu përmbajtur parimeve ligjore të dhënies të pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim I propozon që I njejtë të aprovohet dhe miratohet.

Kryetari
z. Besim Ilazi

Drejtori
z. Ukshin Çallaki



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlade - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarsitvo za Rad i Socijalne Zashite
Ministry of Labour and Social Welfare



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
ЗРПА ЦЕНТРОНС Е АГЕНЦИЈА СЕ ЦЕНТРАЛНО СЕРВИС АГЕНЦИЈА
CENTRAL OFFICE OF THE AGENCY

Arbërisë - Arbërisë - Arbërisë
Drejtori - DREJTORIA - OUTGOING
No. Nr. No. 134 No. 134 No. 134 No. 134
Data - Datum - Date 30.08.2018
Përkrahë - Përkrahë - Përkrahë

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

DATE/A:	30/08/2018
PËR/ZA/TO:	z. BESIM ILAZI, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
CC:	z. SKENDER REÇICA, Minister i MPMS z. IZEDIN BYTYQI, Sekretari i Përgjithshëm, MPMS z. MEMET MULAKU, Udhëheqës i ZP Kaçanik z. FETI IBISHI, Udh. i Divizionit të Prokurimit/MPMS
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	DRIN HARAÇIA, Drejtor i Përgjithshëm i APRK-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për sigurimin e parcelës dhe dokumentacionit teknik përcjellës për ndërtimin e objektit të Zyrës së Punësimit Kaçanik

I nderuar Z. Kryetar,

Ju informojmë që Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), sipas projekteve kapitale për vitin 2018, ka planifikuar të bëjë ndërtimin e objektit të Zyrës së Punësimit në Kaçanik. Duke marrë për bazë që APRK nuk posedon hapësirë në komunën tuaj për ndërtimin e këtij objekti, **Ju drejtohem me kërkesë për ndarjen e parcelës rreth 5 ari, për ndërtimin e objektit të ri të Zyrës së Punësimit, i cili objekt do të jetë përdhese me sipërfaqe bruto rreth 200 m².**

Parcela e propozuar nga ju aktualisht, figuron të jetë pronë shoqërore në emër të BVI-së për banim dhe në mënyrë që të fillojmë këtë ndërtim, kërkojmë të jepet në shfrytëzim kjo parcelë në emër të Zyres së Punësimit në Kaçanik sipas ligjeve dhe procedurave të parapara ligjore, si dhe njëherit kërkojmë sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për ndërtim siç janë:

- Kopja e planit (në emër të Zyres së Punësimit);
- Fletposedimi (në emër të Zyres së Punësimit);

- c. Situacioni;
- d. Kushtet teknike.

Bazuar në parcelën e siguruar prej Kuvendit Komunal, na nevojiten poashtu pëlqimet për kycje në komunal si:

- e. Pëlqimin nga KEDS-i për energji elektrike;
- f. Pëlqimin nga Kompania Rajonale për kycje në ujësjellës dhe kanalizim

Me kompletimin e dokumenteve të sipërpërmendura nga ana juaj neve na mundësohet të punojmë projektin ideor dhe kryesor dhe të fillojmë sa më shpejtë me ndërtimin e Zyrës së Punësimit në Kaçanik, andaj ju lutemi që të na siguroni sa më të shpejtë dokumentacionin e nevojshëm.

Për ndonjë paqartësi eventuale, informatë apo dokument shtesë ju lutem që të na njoftoni dhe kërkonin në çdo kohë dhe njëherit shpresojmë që do të kemi një përgjigje pozitive nga ana e juaj.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MEDITIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00587-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	06-04-02-34197--2018
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	22.10.2018 - 14:24
Komuna / Opština / Municipality:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	KAČANIK / KAČANIK / KAČANIK
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A.TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Superfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917048-00587-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Frengë shpërtimore Društvena Imovina Socially owned Land	Rural	300	16-2018	22.10.2018	22.10.2018

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postel Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Podjedinosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VORREJ VORREJ VORREJ		VORREJ	22.10.2018	22.10.2018

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSIA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsia koriscenje parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Shërbimet Publike Javne Uslugje/PublicServices	Vareze/Croblje/cemetery		300

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Titulli i Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Aktuar Ažurirano Updated
Posedim individual Individualna Drzavina/ single possessor	P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK	KCID0900146	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK /		EMIN DUREKU	1/1		22.10.2018



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarsivo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik

Njësia/ Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m2
P-70917048-00587-2	Parcelë / Parcela / Parcel	300,0
00587-2 34191/18		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 22.10.2018

Koha/ Vreme/ Time: 02:27:42

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtari/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL Datë: 13.11.2018 Nr.020- 1271
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktet komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.104/02-34197/2018 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

I miratuar më datë: 30.10.2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.11.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është **në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekt juridik.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.